



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇËSHTJEVE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE**

Nr. 2102 prot.

Tiranë, më 28 . 09 .2020

URDHËR

Nr. 66 , datë 28 . 09 .2020

**“PËR
NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR ADMINISTRIMIN DHE
KATEGORIZIMIN E ANKESAVE TË DORËZUARA PRANË ORGANEVE
KOMPETENTE GJATË PERIUdhËS KALIMTARE DERI NË KRIJIMIN E
INSTITUCIONIT TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË”**

Në mbështetje të nenit 147/d, të Kushtetutës, të nenit 204, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit të punës për administrimin dhe kategorizimin e ankesave të dorëzuara pranë organeve kompetente gjatë periudhës kalimtare deri në krijimin e institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me përbërje si më poshtë:

- a) Ilma Bici Kryetare;
- b) Alma Troshani anëtare;
- c) Nertil Kanina anëtar;
- ç) Viktoria Spiro anëtare,
- d) Stela Stroka anëtare.

2. Grupi i punës nën organizimin dhe drejtimin e kryetarit dhe në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për Arkiv-Protokollin pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është përgjegjës për:

a) administrimin dhe kategorizimin e të gjitha ankesave të dorëzuara pranë organeve kompetente gjatë periudhës kalimtare dhe të përcjella për trajtim pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;

b) kategorizimin dhe evidentimin e ankesave sipas kriterëve të mëposhtme:

- (i) nr. prot., datë, të organin fillestar kompetent, i cili ka pranuar ankesën;
- (ii) gjeneralitetet e ankuesit;
- (iii) objekti i ankesës;
- (iv) emër dhe mbiemër i subjektit ndaj të cilit është drejtuar ankesa;

(v) data dhe faza e trajtimit të ankesës nga ana e organit fillestar kompetent në momentin e administrimit të saj pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

c) përpunimin dhe pasqyrimin e të dhënave në format elektronik (excel) dhe të printuar sipas rubrikave të përcaktuara në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

d) dokumentimin e të gjithë procesit nëpërmjet hartimit dhe administrimit të procesverbalit për marrjen dhe dorëzimin e ankesave, si dhe raportin javor mbi trajtimin e tyre.

3. Grupi i punës, me hyrjen në fuqi të këtij urdhri, nënshkruan procesverbalin e marrjes në dorëzim të të gjitha ankesave të administruara.

4. Grupi i punës dorëzon raportin javor mbi procesin dhe rezultatet e punës së kryer, pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

5. Ngarkohet grupi i punës me zbatimin e këtij urdhri brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi.

6. Ngarkohet sektori përgjegjës për Arkiv-Protokollin dhe anëtarët e grupit të punës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË TË DREJTËSISË

Artur Metani



Konceptoi: E. Bylykbashi
Pranoi: D. Pasko
Miratoi: D. Pasko
Konfirmoi: D. Pasko
6 kopje/ datë: 28.09.2020

Lidhja Nr. 1 "PASQYRA E TË DHËNAVE ELEKTRONIKE PËR KATEGORIZIMIN E INFORMACIONIT ADMINISTRUAR NGA ANKESAT"

1	2	3	4	5	6				7	8					
NR.	NR. PROT. DATA E INSTITUCIONIT DËRGUES	GJENERALITETET E ANKUESIT	OBJEKTI I ANKESËS	EMRI MBEMIRI I SUBJEKTT NDAJ TË CILIT PARAQITET ANKESA	FAZA E TRAJTIMIT NGA INSTITUCIONI DËRGUES				Praktika të ardhura nga Presidenti	SHËNIME:					
					Shqyrtim paraprak	Proces verifikim	Hetim disiplinor		Kërkesë për procedim disiplinor	Informacione periodike	Përkrahim	Verifikim	Hetim		
							Në proces	Përfunduar							
															(në këtë rubrikë mund të përcaktohet çdo informacion nëse vlerësohet i nevojshëm për qëllime të evidentimit të çdo Hoji informacioni i jetër.